

MUHARREM DEZHGIU

**HASAN PRISHTINA NË LËVIZJET POLITIKE
(1920-1924)***

Atdhetari Hasan Prishtina ka hyrë në historinë e shqiptarëve me një veprimtari të gjerë politike, diplomatike, ushtarake, duke skalitur emrin në plejadën e luftëtarëve të paepur të lëvizjes kombëtare çlirimtare të shqiptarëve. Atë nuk e joshën gradat, ofiqet dhe postet për ta larguar nga veprimtaria e tij revolucionare. Ai qëndroi në pozicionin e opozitarit të përjetshëm kundër të gjithë armiqve të kombit shqiptar. Siç e ka deklaruar vetë “në vend të një kolltuku me turp në Stamboll preferoi kryengritjen me nder në malet e Kosovës”¹. Dhe Kosova e çështja e çlirimit të saj, si pjesë e pandarë e kombit shqiptar do të bëhej lajtmotivi i të gjithë veprimtarisë së Hasan Prishtinës, deri në fund të jetës së tij.

*

* * *

Në mbarim të Luftës I Botërore Shqipëria u ndodh përballë rrezikut të madh të copëtimit të saj. Shqiptarëve iu desh të luftonin ende më tej, për të ruajtur të paprekur pavarësinë territoriale të shtetit shqiptar si dhe të shtonin përpjekjet për bashkimin e tokave që kishin mbetur jashtë këtyre kufijve nga vendimet arbitrare të Fuqive të Mëdha.

Hasan Prishtina, me cilësinë e kryetarit të delegacionit të Komitetit të Kosovës, në Konferencën e Paqes, edhe pse nuk mori pjesë, kërkoi në emër të Kosovës e të Dibrës “që të gjithë shqiptarët të “bashkohen” në një shtet të pavarur sipas parimit të sovranitetit kombëtar”².

Në fund të kësaj lufte, Shqipëria dhe shqiptarët, do të ndodheshin përpara disa sfidave të vështira. Ato duhej të konfirmonin pavarësinë dhe integritetin tokësor të shtetit të pavarur shqiptar, të legjitimonin shtetin e tyre të

* Kumesë e mbajtur në sesionin shkencor organizuar në kuadrin e veprimtarisë “Ditët e Hasan Prishtinës”, Vushtri, 8 tetor 2009.

¹ *Ora e Shqipnisë*, Vjenë më 22 maj 1928, nr.7. Deklaratë e Hasan Prishtinës nën titullin “Deri në vdekje”.

² *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSh*), Fondi 54, dos. 67/1, fl. 169. Telegram i Hasan Prishtinës drejtuar Sotir Kolesë, Romë, më 29 janar 1919.

aftë për të mbrojtur interesat kombëtare në plan ndërkombëtar por edhe të mbanin gjallë aspiratën për zgjidhjen e padrejtësive historike, që i ishin imponuar kombit shqiptar.

Sigurisht, që këto detyra nuk mund të zgjidheshin në mënyrë ballore dhe njëhershmi, sepse zgjidhja e tyre kushtëzohej nga veprimi i shumë faktorëve të brendshëm e të jashtëm. Gjithë kujdesi dhe vëmendja e politikanëve të kohës, për zgjidhjen e këtij ekuacioni politik të çështjes shqiptare, duhej përqendruar brenda kufirit të së mundshmes reale. Me fjalë të tjera, përballimi i sfidave të bëhej në mënyrë të tillë, që zgjidhja e një detyre të krijonte kushte e mundësi reale për zgjidhjen e detyrës tjetër.

Në këto rrethana, ishte meritë historike e shqiptarëve dhe politikanëve më vizionarë të tyre, që zgjidhjen e detyrave e filluan me organizimin dhe ndërtimin e organeve qendrore të shtetit, nëpërmjet thirrjes së Kongresit Kombëtar të Lushnjës. Vendimet e këtij Kongresi konfirmuan vendosmërinë e shqiptarëve për t'iu dalë zot fateve të veta, jo vetëm për t'iu kundërvënë vendimeve të Konferencës së Paqes që cenonin integritetin territorial të Shqipërisë, por dhe vendosmërinë për bashkimin e trevave shqiptare të pushtuara.

Shqiptarët të vendosur në barrikatat e fuqishme në Vlorë, Koplik e Dibër, me luftën e tyre, siguruan pavarësinë kombëtare e tërësinë e Shqipërisë në kufijtë e vitit 1913³.

Situata e krijuar pas këtyre fitoreve dukej se do të krijonte qëndrueshmëri në situatën e brendshme dhe vendi mund të futej në rrjedhën e një modernizimi të qetë. Për fat të keq, nuk ndodhi kështu. Sipas konstatimeve të studiuesve të huaj “shqiptarët filluan grindjet e tyre të vjetra mes tyre. Realiteti i politikës shqiptare të pasluftës ishte ai që kishte qenë më parë. Gjithçka vendosej në funksion të personalitetit të individit dhe numrit të pushkëve që ai ishte në gjendje të mblidhte rreth vetes”⁴.

Pothuajse të gjitha zhvillimet e brendshme politike në vitet 1921-1924 i përqasen përfundimit që kanë arritur studiues të kësaj periudhe historike të shqiptarëve.

Zgjedhjet e përgjithshme të 5 prill 1921, të parat pas Kongresit të Lushnjës, u karakterizuan nga ashpërsimi i luftës së brendshme politike. Kjo gjë u bë shkak për një paqëndrueshmëri të theksuar qeveritare.

Hasan Prishtina do të vinte në Këshillin Kombëtar si deputet i Dibrës. Diskutimet e tij të zjarrta në parlament kanë si kryefjalë, çështjen kombëtare. Mbi të gjitha, ai dënoi ashpër veprimet barbare të qeverisë së Beogradit, për

³ Xhevat Repishti, “Lufta kundër intervencionit ushtarak jugosllav në Shkodër më 1920 (Lufta e Koplikut)”, *Studime historike*, nr. 2, 1972, f. 59.

⁴ Bernd J. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë: “Çabej”, 1996, f. 36.

vazhdimin me egërsi të fushatës së zhdukjes në masë të popullsisë shqiptare, nëpërmjet operacioneve çnjerëzore, kolonizimit me popullsi serbe të Kosovës, sipas të ashtuquajturës “reformë agrare”. Duke hedhur poshtë protestat e qeverisë jugosllave, për gjoja, ndërhyrje të “padrejtë” nga ana e Shqipërisë, Hasan Prishtina do t’i përgjigjej se “kemi të drejtë me u anku dhe me i hjek vërejtjen parlamentit jugosllav për masakrat dhe barbarizmat e panumërta që po i bëhen popullit shqiptar në Kosovë, pse pa farë mëshire po vriten e mbyten gra, fëmijë ... vetëm se janë shqiptarë”⁵.

Lufta e brendshme politike shkaktoi krizat qeveritare që kishin filluar që me dorëheqjen e qeverisë së Sulejman Delvinës, duke arritur kulmin e thellimit të krizave në gjysmën e dytë të vitit 1921. Nga gjysma e dytë e tetorit deri në fillim të dhjetorit 1921 erdhën në fuqi 5 qeveri (P. Evangjeli, K. Koculi, H. Prishtina, I. Kosturi, Xh. Ypi).

Më 7 dhjetor 1921 u formua qeveria e kryesuar nga Hasan Prishtina, në të cilën bënin pjesë figura të njohura, si: Fan Noli, H. Kadriu, L. Gurakuqi, Z. Dibra. Këtë barrë të rëndë Hasan Prishtina e mori me përgjegjësinë e shpëtimit dhe përparimit të atdheut. Që në urdhrin e parë të kësaj qeverie thuhej se “Shpëtimi dhe përparimi i atdheut varet në qetësinë e bashkëveprimit të gjithë bashkatdhetarëve”⁶.

Me gjithë dëshirën e mirë të kryetarit të qeverisë, kriza qeveritare nuk u frenua. Në qeverinë e Hasan Prishtinës, vendin e ministrit të Brendshëm e kishte marrë Luigj Gurakuqi.

Ahmet Zogu, një figurë me peshë në jetën politike të shtetit shqiptar, kishte fituar shumë autoritet në shtypjen e ndërhyrjes jugosllave në Mirditë (e ashtuquajtura Republikë e Mirditës). Pikërisht në këtë kohë u formatua një lëvizje që u quajt “Lidhja e Shenjtë” ose “Bashkimi i Shenjtë”. Në të bënin pjesë Hasan Prishtina, H. Kadriu, B. Curri, si dhe L. Gurakuqi.

Qëllimi i shpallur i kësaj lëvizjeje ishte kapërcimi i grindjeve të brendshme përballë rrezikut të jashtëm, por në themel ishte ideja “irredentiste”, fati i Kosovës.

Me autoritetin e figurës qendrore të rezistencës kundër ndërhyrjes jugosllave në Veri (me “Republikën e Mirditës”), Zogu erdhi në Tiranë në krye të forcave të armatosura fitimtare. Fundi i dhjetorit 1921 i forcoi edhe më shumë pozitat e Zogut. Ai, si ministër i Brendshëm i qeverisë së Xhaferr Ypit u

⁵ *AQSh*, Fondi 246, dos. 81, fl.55-57. Diskutim i H. Prishtinës në Këshillin Kombëtar, me 16 korrik 1921.

⁶ *Shkumbini*, Elbasan, 8 dhjetor 1921, nr. 41. Urdhri i parë i Qeverisë së Hasan Prishtinës, 8 dhjetor 1921.

bë dora e djathtë e kësaj qeverisjeje. Në këto rrethana “Bashkimi i Shenjtë” që kishte gjetur shprehje e shpresë te qeveria e Hasan Prishtinës, u prish⁷.

Këshilli Kombëtar i mbledhur më 22 dhjetor 1921, i cili mori në analizë ngjarjet e dhjetorit, ua hoqi mandatin deputetëve në radhët e të cilëve ishte edhe Hasan Prishtina. Këtij të fundit nuk i mbetej gjë tjetër, veçse të deklaronte në parlament se “Shqiptarët nuk mund me ja lidh gojën, jo dyfeku, po as topi”⁸.

Me masat që mori qeveria e Xh.Ypit, për stabilitetin e vendit si “gjyqi i lartë” për ndjekjen penale të personave të implikuar kundër qeverisë, aksioni për çarmatimin e popullsisë, si një domosdoshmëri për vendosjen e autoritetit të shtetit në çdo skaj të vendit, dukej qartë se po kalohej nga debati në parlament në konfrontime të dhunshme. Kursi i përdorimit të forcës nga ministri i Brendshëm A.Zogu e bindi Bajram Currin, për një rrezik të brendshëm, për tendencat e A.Zogut për pushtet personal⁹. Në këto kushte rikthehet “Bashkimi i Shenjtë” duke marrë qëndrim të hapur kundër qeverisë, duke bërë thirrje për mobilizim kundër qeverisë, për të realizuar dhe idenë e tyre thelbësore irredentiste. Ata shpresonin se do të ndikonin për ta mbajtur gjallë çështjen e Kosovës në politikën e shtetit shqiptar. Ata prisnin të ndërmerreshin iniciativa në arenën ndërkombëtare, për të tërhequr vëmendjen te keqtrajtimi i popullsisë shqiptare e për të sensibilizuar faktorin ndërkombëtar për padrejtësitë e bëra shqiptarëve.

Si kundërshtar të kësaj lëvizjeje, B.Curri, H.Prishtina, E.Isufi etj., njihnin Zogun e bashkëpunëtorët e tij. Këta të fundit mendonin se “Shqipëria, së pari duhet të konsolidohej si shtet, prandaj nuk mund të ndërmerrete një politikë irredentiste”.

Në këto rrethana tepër të ashpra, midis këtyre dy grupimeve u zhvilluan ngjarjet e marsit 1922, e cila njihet si një lëvizje e armatosur midis forcave të B. Currit, E. Isufit, Hasan Prishtinës, të cilat rrethuan Tiranën për të rrëzuar qeverinë e Xhaferr Ypit. Barrën për të qëndruar e mori ministri i Brendshëm, A. Zogu. Vetëm ndërhyrja e ministrit të Brendshëm në Tiranë, Harry Eures (Aires), në bisedë me Elez Isufin e “çliroi” situatën. Ai arriti të bindte bashkëbiseduesin se trazirat mund të shfrytëzoheshin nga jugosllavët.

B. Curri dhe Hasan Prishtina u strehuan në Malësinë e Kukësit. Një gjykatë ushtarake dha dënime të rënda pas shpartallimit të kësaj lëvizjeje (8 – 22 mars 1922). Gjatë gjithë kohës më pas, Hasan Prishtina, B.Curri, Gurakuqi, punuan për rrëzimin e Zogut, çka e realizuan me ardhjen në fuqi të qeverisë së Nolit, në qershor të vitit 1924, pas një kryengritjeje të dhunshme. Në

⁷ Hysen Kordha, “Ngjarjet e dhjetorit, 1921”, në *Studime historike*, 1974, nr.1, f.41.

⁸ *AQSh*, Fondi 246, dos.62, fl.586. Shih Hasan Prishtina, *Dokumente*, Tiranë 1983, f.123.

⁹ Arben Puto, *Shqipëria politike, 1912-1939*, Tiranë: “Toena”, 2009, f.324-325.

veprimtarinë e shkurtër të kësaj qeverie, Hasan Prishtina, Noli, Gurakuqi, Curri e Pejani përbënin delegacionin shqiptar në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë, të cilët i paraqitën Këshillit të Lidhjes së Kombeve një memorandum mbi masakrat serbe kundër shqiptarëve¹⁰.

Veprimtarinë e mëtejshme politike e diplomatike për çështjen e Kosovës, Hasan Prishtina e zhvilloi në emigracion, duke shfrytëzuar dhe lidhjet diplomatike me qarqe të caktuara të huaja që mbështetnin “irredentizmin” shqiptar.

¹⁰ *AQSh*, Fondi 251, dos. 208, fl.1-4. Memorandum i firmosur nga Hasan Prishtina, Bajram Curri etj., Gjenevë, 26 shtator 1924.

